



MBROJTJE TË MJEDISIT

Analiza për shpenzimet dhe përfitimet:
Shfrytëzimi përkatës mjeteve publike për realizimin
e politikës publike për mbrojtje të mjedisit jetësor



Stërvitje:

Autorë

Andonoska Elena

Bojana Bozhinovska

Stefan Mlladenovski

Bllazhe Josifovski

Asociacionit për mjedis të pastër jetësor "Hajde Maqedoni"

Mentorë: Natasha Trajkova - Fakultet ekonomik, Prilep

Përktheu: Zejnula Veseli

HYRJE

Mbeturinat në botë konsiderohen si një ndër problemet më të mëdha ekologjik. Trendi që të shfrytëzohen më shumë resurse materiale (për shkak të kërkesës së rritur), e ndërlidhur me trajnimin joadekuat të mbeturinave, ka dy implikacione kryesore: ekologjik dhe ekonomik. Menaxhimi i mbeturinave si pjesë e politikës për mbrojtje të mjedisit jetësor ka për qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e pasojave nga ndikimet e dëmshme ndaj ajrit, ujit dhe tokës, ndërsa më këtë edhe ndaj shëndetit të popullatës. Mënyrat e qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave (ulje në minimum të krijimit të mbeturinave, ripërdorim i prodhimeve dhe reciklim) kontribuojnë drejt krijimit të zvogëluar të mbeturinave, shpenzim i zvogëluar i resurseve natyrore (materiale dhe energjetike), si dhe drejt sigurimit të qarkullimit të materies dhe të energjisë në natyrë. Përkundër kësaj, me mënyrat e paqëndrueshme dhe mundësitë e padëshiruara të menaxhimit të mbeturinave (deponim dhe djegie¹), materialet e përmbajtura në të, si dhe energjia e përdorur për krijim të saj, në mënyrë të pakthyeshme humben, ndërsa në mënyrë plotësuese krijohen materie toksike që e ngarkojnë mjedisin jetësor.²

Me qëllim të mbledhjes së praktikës së deritanishme të menaxhimit të mbeturinave në R.Maqedonisë dhe shqyrtimi i mundësive të ardhshme, në këtë analizë të shpenzimeve dhe përfitimeve do të analizohen dy qëllime të individuale nga politika për menaxhim të mbeturinave, më konkretisht mbeturinave komunale, prej të cilëve njëri i dedikohet **harmonizimit të rregullativës ligjore me BE-në**, ndërsa tjetra **përmirësimit të infrastrukturës teknike**. Kjo analizë do të shfaqë se nëse ekziston fitimprurje ekonomike të angazhimit të deritanishme në sferën e ekologjisë, do t'i theksojë përfitimet shëndetësore dhe sociale nga vendosja e ardhshme e deponive standarde, si dhe do të projektojë përfitime financiare nga zhvillimi i industrisë përpunuese. Rezultatet e pritura nga analiza janë: rezultat i konsiderueshëm pozitiv, në qoftë se investohen investimet e nevojshme në infrastrukturë, mbeturina përpunohet në pjesën më të madhe, ndërsa pjesa e mbetur deponohet në deponi standarde rajonale – ndërkomunale, të cilët do të jenë më pak në numër, ndërsa secila do të shërbejë një numër më të madh të popullatës, në krahasim me numrin e deponive ekzistuese³. Përkundër pritjeve, gjendja reale është në mënyrë drastike më ndryshe, madje edhe rezultati i fituar për gjendjen e tanishme, në kuptim të menaxhimit të mbeturinave, do të sillte deri në humbje financiare dhe mirëqenie të përkeqësuar të popullatës.

1 Insineracioni paraqet proces të djegies së kompletuar të kontrolluar të mbeturinave të forta.

2 Megjithatë djegia mund të ketë edhe përfitime të caktuara, posaçërisht në uljen të vëllimit të mbetrinës, Por vërtet në qoftë se realizohet sipas standardeve më të larta dhe temperaturë minimum prej 1.100 °C.

3 Sjellja e deponive rajonale (çdo deponi rajonale përfshin më shumë komuna, gjegjësisht një rajon të posaçëm nga territori i vendit) është me rëndësi të posaçme, për shkak se për momentin ekzistojnë shumë deponi jostandarde komunale (në disa komuna ka edhe më shumë se një deponi, ndërsa krahas tyre edhe të egra). Për shkak të shpenzimeve të rritura nuk është fitimprurëse që një deponi të funksionojë për më pak se 200.000 banorë.

FAKTE PËR POLITIKËN DHE PËR GJENDJEN

Që të udhëzohet lexuesi në analizën e përpunuar për shpenzimet dhe për përfitimet, do të fillojmë me shpjegimin e gjendjes së tanishme në sferën e menaxhimit të mbeturinave në Maqedoni.

Në qoftë se shqyrtohet gjendja me mbeturinat në vend, e prezantuar edhe në Planin kombëtar për menaxhim me mbeturina nga periudha 2009-2015 (Министерство за животна средина и просторно планирање, 2008), mund të konfirmohet se nuk ekziston sistem i organizuar adekuat, i cili do t'i shfrytëzonte potencialet e menaxhimit të mbeturinave në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit jetësor, krijim të përfitimeve ekonomike dhe mundësim të parimit të qëndrueshmërisë së resurseve. Ndoshta forma e vetme e organizimit të veçantë është e pranishme në pjesën e menaxhimit të mbeturinave komunale, që është edhe lëndë e kësaj analize, edhe pse nuk bëhet fjalë e vërtetë për ndonjë lloj të menaxhimit, por për grumbullim dhe për deponim të mbeturinave të përziera të forta komunale nga amvisëritë edhe nga personat juridik të deponive eksizuese komunale. Paralelisht, funksionon edhe deponimi ilegal dhe stihike të mbeturinave të deponive të egra, në mungesë të shërnimit adekuat dhe kapacitetit nga ana e ndërmarrjeve komunale për servisim të të gjithë pjesëve të vendit, si dhe niveli i ulët i vetëdijes tek qytetarët për pasojat nga mënyra e tillë e heqjes së mbeturinave.

Duke pasur parasysh gjendjen, është bërë Strategji për menaxhim të mbeturinave për periudhën 2008-2020 – SMM (Влада на РМ, 2008) ndërsa drejtëpërdrejtë pastaj edhe PKMM. Si qëllime kryesore të PKMM, të cilët janë marrë si bazë për këtë analizë janë:

- Harmonizimi i legjislacionit me legjislacionin evropian
- Ndarje e obligimeve, detyrave, përgjegjësisë dhe ngritje të kapaciteteve të të gjithë subjekteve të inkuadruara në menaxhimin e mbeturinave
- Ulje e ndikimit të mjedisit jetësor me formim të rrjetit të infrastrukturës teknike nga kapacitetet për menaxhim të mbeturinave
- Sigurim i rrjedhave së të ardhurave për realizim të shërbimeve që do t'i sigurojë sistemi i zhvilluar dalëngadalë për menaxhim të mbeturinave
- Kuptimi i problemeve me mbeturinat dhe roli i të gjithë subjekteve të inkuadruara dhe i ndryshimeve të paevitueshme politike/strukture, pjesëmarrja pozitive e opinionit në mbështetje të projekteve për menaxhim me mbeturina

Nga qëllimet e përmendura, gjatë kësaj analize për shpenzimet dhe përfitimet vendosëm të kushtojmë më shumë vëmendje dhe t'i përfshijmë qëllimet për **afrimin e rregullativës së BE-së në pikëpamje të menaxhimit të mbeturinave** si parakusht primar për rregullim të kësaj sfere, si dhe në **uljen e ndikimeve të mjedisit jetësor me formim të rrjetit të infrastrukturës teknike nga kapacitetet për menaxhim të mbeturinave**, për arsye se kjo paraqet themelin e domosdoshëm të sistemit të qëndrueshëm për menaxhim efikas të mbeturinave, por edhe për shkak të përfshirjes së kufizuar të analizës, kufizimit të së dhënave me të cilat disponon vendi, si dhe për

shkak të shkallës së ulët të realizimit të politikës në realitet, ngushtohet përqendrimi në pjesët e politikës.

Sjellja e kësaj infrastrukture, mes tjerash, nënkupton edhe hapje të tetë qendrave rajonale për menaxhim të mbeturinave komunale në gjithë territorin. Në qoftë se shqyrtohet rrjedha e deritanishme e sjelljes së këtij sistemi rajonal, mund të shihet se realizimi i tij paraqet një proces shumë i ngadalshëm, rezultatet e të cilit pasqyrohen në grumbullim joefikas dhe joefektiv, bartje dhe largim të mbeturinave të forta komunale. Në pjesën më të madhe janë sjellur dokumentet përgatitore, por, megjithatë, ka vonesa lidhur me afatet e vendosura.

Sipas bisedës me udhëheqësen e Sektorit për menaxhim të mbeturinave pranë Ministrisë dikasteriale, Ana Karanfillova, plane rajonale janë miratuar vetëm për rajonin lindor dhe verilindor, bashkë me vlerësimin strategjik të ndikimit ndaj mjedisit jetësor. Për këto dy rajone po realizohet përgatitja e dokumentacionit të tenderit dhe atij teknik për mbyllje të deponive ekzistuese komunale të egra dhe jostandarde. Përpilimi i planeve rajonale për rajonin e Pollogut, Juglindor dhe të Vardarit, Pellagonisë dhe rajonin Juglindor, është në kuadër të komponentës 3 të IPA-s dhe projekti është në fazë të tenderit. Në rajonet në të cilët nuk janë miratuar plane rajonale, nuk ka mundësi për rregullim të qëllimeve të përbashkëta të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, siç kërkohet në SMM dhe PKMM. Tek të dy rajonet që janë dhënë nën koncesion për financim, projektim, ndërtim dhe për menaxhim të deponisë rajonale, gjegjësisht për rajonin e Pollogut dhe Juglindor, koncesionet janë shfuqizuar me vendime të Qeverisë së R.Maqedonisë (Службен весник на РМ бр. 142/2014 dhe 177/2014). Praktiskisht, vendosja e sistemit rajonal të deponive është në fazë të dokumentacionit, ndërsa në realitet ndërtimi as që ka filluar.

Lidhur me mbylljen dhe remediacionit⁴ të deponive jostandarde komunale sipas Planit për mbyllje të deponive jostandarde (Министерство за животна средина и просторно планирање и шведска Агенција за заштита на животна средина, 2011) dhe PKMM, përveç deponisë "Drislla", e cila përmbush minimum standarde, deponitë e tjera komunale nëpër vend nuk i përmbushin standardet në pajtueshmëri me Ligjin për menaxhim të mbeturinave dhe nevojitet mbyllja dhe remediacioni i tyre deri në hapjen e deponive rajonale (faqe 13-14). E shfaqur në numra në vetë PKMM-në, kjo duket kështu: 16 janë të përcaktuara si deponi me rrezik të lartë, 16 me rrezik të mesëm dhe 22 me rrezik të ulët. Sipas informatave që i morëm nga një pjesë e deklaratës së udhëheqëses së Sektorit për menaxhim të mbeturinave, Ana Karanfillova, nuk është bërë progres i rëndësishëm në drejtim të mbylljes ose sanimit të deponive jo të standardizuara në Maqedoni.


Ekziston nevojë urgjente për sjellje të pajisjes së re dhe hapje të ndërmarrjeve që do të merren me përpunim të mbeturinave. Ato që ekzistojnë edhe ende funksionojnë, sipas Programit për menaxhim të mbeturinave nga paketimi (Министерство за животна средина и просторно планирање, 2011), me gjithçka, me të vërtetë, kapacitet të kufizuar edhe atë për fraksione të caktuara si: plastikë, letër dhe metal. Pjesa më e madhe e

4 Remediacion – ripërtëritje, sjellje e sërishme në gjendje natyrore.

mbeturinave që janë selektuar edhe mund të reciklohet, eksportohet për këtë dedikim. Krahasuar, sipas statistikës së Eurostatit (2015) sasia e mbeturinave komunale në vitin 2013, në Maqedoni është 384 kg, ndërsa në Gjermani 617 kg për kokë banori. Grafikonët e poshtëm e shfaqin gjendjen me mbeturinat komunale në RM, në periudhën 2009-2014, ndërsa edhe japin pasqyrim të përbërjes së mbeturinave komunale në RM si vend me zhvillim të mesëm, sipas Bankës Botërore (World Bank, 2012).


Grafiku 1.

Numri i deponive komunale sipas klasës së rrezikut




Grafiku 2.

Mbeturinat komunale



Grafiku 3.

Përçindja e pjesëmarjes të llojeve tjera të mbeturinave



Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) përmes organit të saj – Drejtorisë për mjedis jetësor është e obliguar ta kryejë monitorimin e menaxhimit të mbeturinave në R. Maqedonisë. Në pajtueshmëri me Ligjin për menaxhim të mbeturinave (Службен весник на РМ бр.68/2004), neni 55, MMJPH është e obliguar që të miratojë Program për monitorim dhe për të në nivel vjetor të dorëzojë raport. Sipas të gjithë burimeve zyrtare MMJPH deri më tani nuk e ka bërë këtë. Në mënyrë plotësuese, sipas nenit 116 nga Ligji për menaxhim të mbeturinave, MMJPH është e obliguar të sjellë dhe udhëheqë kadastër të mjedisit jetësor, në kuadër të së cilit është kadastrë për krijuesit e mbeturinave, por, sipas të gjithë burimeve zyrtare të të dhënave, kjo nuk është bërë.

Sipas nenit 117 nga Ligji për menaxhim të mbeturinave, MMJPH paraqitet edhe në rolin e burimit kryesor të informatave për opinionin më të gjërë për menaxhimin e mbeturinave. Megjithatë, efikasiteti i këtij funksioni është i kushtëzuar nga disa sfida, midis tyre paraqitet ajo që regjistri i vepruesve me mbeturina, të cilin e udhëheqë MMJPH, disponon me informata të pamjaftueshme, gjegjësisht përmban të dhëna vetëm për lejet e ndryshme që i ka dhënë organi, në pajtueshmëri me llojet e mbeturinave. Edhe pse, sipas nenit 113 nga Ligji për menaxhim të mbeturinave, organi shtetëror kompetent për mjedisin jetësor është i obliguar që të dhënat nga raportet vjetore nga personat juridik dhe fizik t'i publikojë si bazë e të dhënave, sipas të dhënave nga ueb-faqja zyrtare e organit shtetëror, ai nuk e kryen këtë obligim ligjor. Edhe një vështirësi paraqet zbatimi jodinjitoz i metodologjisë për përlogaritje dhe publikim të informatave që publikohen për gjendjet në mjedisin jetësor, që pamundëson krahasim të tërësishëm të së dhënave nëpër disa vite. Edhe pse është, me të vërtetë, mbresëlënëse spektri i raporteve të përgatitura dhe publikuara nga ana e MMJPH-së, në bashkëpunim me Entin për statistikë, megjithatë jokonzistenca në mënyrën e raportimit kontribuon për informim të dobët të opinionit me menaxhimin e mbeturinave në R. Maqedonisë.

Fazat fillestare dhe zhvillimi i ngadalshëm i menaxhimit rajonal të mbeturinave në Maqedoni, e plotësuar me mosmbylljen dhe remediacionin e deponive të pastandardizuara komunale, sjellë deri në dëme të konsiderueshme ndaj shëndetit të qytetarëve dhe ndikim negativ mbi gjithë mjedisin jetësor. Nga kjo arsye, shohim rëndësi të madhe në përpunimin dhe prezantimin e rezultateve nga kjo analizë, me dëshirë që të japim kontribut në qëllimin e përbashkët – ndërtim të vetëdijes së përgjithshme për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit jetësor ose, më konkretisht, menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

QËLLIMET E PËRZGJEDHURA TË POLITIKËS PUBLIKE SI LËNDË E ANALIZËS

HARMONIZIMI RREGULLATIVËS SË BE-SË NË LEGJISLACIONIN KOMBËTAR


Me qëllim që më hollësisht të shqyrtohet gjendja reale në legjislacionin kombëtar dhe më mirë të kuptohen aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me harmonizimin e tij me rregullativën e BE-së në këtë sferë, shkurt pason kontroll i aspekteve në pikëpamje me këtë qëllim.

Si ligj që, përgjithësisht, i rregullon parimet për mbrojtje të mjedisit jetësor në RM paraqitet Ligji për mjedis jetësor. Ligji për menaxhim të mbeturinave paraqet bazë në këtë sferë dhe me të vendosen parimet dhe rregullat themelore për menaxhim të mbeturinave. Me këtë ligj bëhen përpjekje serioze që të vendoset rregulli “ndotësi paguan” përmes një sërë masash, por edhe dispozita ndëshkuese. Sipas Sapuric et al. (2015), Ligji e promovon sistemin e licencave të dhëna, nxitje dhe mbështetje për zvogëlim të mbeturinave, aktivitete për ripërtëritje dhe për instrumente ekonomike. Pikërisht në këtë ligj dhe aktet nënligjore që u dedikohen atij, ekziston harmonizim i konsiderueshëm i direktivave kryesore të BE-së nga kjo sferë: Direktiva kornizë për mbeturina 2006/12/EZ dhe Direktiva për mbeturina 2008/98/E3, e cila në vëllim të madh e zëvendëson direktivën paraprake; Direktiva për mbeturina të rrezikshme 1991/689/EE3; Direktiva për djegie 2000/76/E3; Direktiva për deponi 1999/31/E3, si dhe Rregullativa për transport të mbeturinave 1013/2006/E3. Progres tejjet i rëndësishëm është bërë me Ligjin për paketim dhe për mbeturina nga paketimi (Службен весник на РМ бр.161/2009) dhe aktet nënligjore si: Lista e shembujve të ilustruar për paketim (Службен весник на РМ бр. 52/10), e cila duhet të plotësohet dhe azhurnohet në pajtueshmëri me BE-në, si dhe Rregulloren për standardet e dekompozimit të qeseve (Министерство за животна средина и просторно планирање, 2013) dhe të tjera, me të cilët realizohet Direktiva e BE-së nga 1994/62/E3, e cila i dedikohet këtij lloji të mbeturinave dhe vendosen një sërë qëllimesh standarde dhe kombëtare për mbeturina të ambalazuara. Në tabelën që pason është shfaqur progresi në këtë sferë

për vitin 2011 krahasuar me vitin 2014. Madje shuma e përgjithshme e mbeturinave të gjeneruara nga paketimi është marrë sipas projeksioneve të Programit për menaxhim të mbeturinave nga paketimi (Министерство за животна средина и просторно планирање, 2011), ndërsa mbeturinat e grumbulluara dhe të recikluara është shfaqur në pajtueshmëri me sasitë e paraqitur nga ana e vepruesve kolektiv.

Grafiku 4.

Të gjeneruara, grumbulluara dhe reciklime totale



Ligji për menaxhim të baterive dhe akumulatorëve dhe baterive dhe akumulatorëve jashtë përdorimit (Службен весник на РМ бр.140/2010) dhe aktet e tij nënligjore midis të cilëve edhe rregullorja për mënyrën e shënimit të baterive dhe akumulatorëve (Службен весник на РМ бр. 52/2011), janë zbatuese të po të njejtës Direktivë të BE-së nga 1991/157/EEZ, ndërsa me Ligjin për menaxhim të pajisjes elektronike dhe elektrike dhe pajisje elektrike dhe elektronike jashtë përdorimit (Службен весник на РМ бр. 6/2012) me aktet nënligjore, si p.sh.: Rregullorja për kërkesat minimale për trajtim të ndarë të pajisjes jashtë përdorimit (Службен весник на РМ бр. 9/13), me të cilët përafrohet direktiva e BE-së për 2006/21/E3, i rregullojnë llojet konkrete të mbeturinave dhe menaxhimit me ato lloje specifike të mbeturinave. Për dallim nga pajisja elektrike dhe elektronike ende është herët që të jepet ndonjë vlerësim për shkak se zbatimi i rregullativës ligjore është që në fillim dhe raportet e para nga vepruesit e autorizuar kolektiv, gjegjësisht nga operatorët e autorizuar, ende priten.

Në pajtueshmëri me PKMM-në për MMJPH-në është parashikuar që të punësohen kuadrot vijuese: në sektorin për mbeturinë të ketë gjithsej 14 të punësuar, dy përgjegjës të rinj të punësohen për problematikën me mbeturinat në Qendrën informative të Maqedonisë për mjedis jetësor, dy punësime të reja shtesë në zyrën për komunikim me opinionin dhe 10 inspektorë të rinj në Inspektoratin për mjedis jetësor, ndërsa e gjithë kjo në periudhën nga gjashtë vitet e kaluara për të cilët u dedikohet edhe PKMM-ja. Sipas të dhënave të dhëna për sektorët në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor, sektori për mbeturina ende ka tetë të punësuar, ndërsa për sektorët e tjerë të përmendur nuk kemi konfirmim se janë punësuar personat e planifikuar.

ULJE E NDIKIMIT TË MJEDISIT JETËSOR ME FORMIM TË RRIJTJES TË INFRASTRUKTURËS TEKNIKE NGA KAPACITETET PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Vendosja e infrastrukturës teknike nga kapacitetet për menaxhim me mbeturina, e cila tanimë para shumë kohësh ekziston në vendet e zhvilluara evropiane, është një prej qëllimeve prioritare, e cila tërheq edhe përqindje më të madhe të investimeve kapitale, ndërsa me këtë edhe shpenzime më të mëdha të politikës publike. Madje, prej atje analizën e përqendruan në aspektet vijuese të këtij qëllimi, të cilët janë paraparë në PKMM:

1. Vendosje graduale e infrastrukturës me kapacitete për menaxhim të **mbeturinave të forta komunale**, në nivel rajonal, me sistem adekuat për pagesë efikase dhe efektive të shpenzimeve dhe logjistikë transportuese për fraksione të ndryshme të mbeturinave
 - për periudhën prej gjashtë vitesh (2009-2015) është paraparë që të hapen qendra rajonale për menaxhim të mbeturinave të forta komunale, si dhe të sendërtohet deponia ekzistuese "Drislla", e cila do të funksiononte si deponi qendrore rajonale.
2. Mbyllje e deponive që nuk janë në pajtueshmëri me standardet e BE-së
 - rreth 40 deponi me rrezik të lart/të mesëm sipas programit sipas programit për menaxhim të **mbeturinave të forta komunale** në periudhën kalimtare
3. Vendosja e kapaciteteve për përpunim për material/energji për rrjedhat e posaçme të mbeturinave dhe prodhimet e përdorura në pajtueshmëri me parimin për "përgjegjësi të prodhuesit"
 - në këtë pjesë të analizës përqendrim i veçantë u është dhënë **mbeturinave të forta komunale, mbeturinave nga paketimi, mbeturinave elektronike dhe mbeturina të baterive dhe akumulatorëve (MBA)**.

ANALIZË PËR SHPENZIMET PËR PËRFITIME TË SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA DHE EFEKTET POTENCIALE NË AFAT TË GJATË

Esenca e çdo analize të shpenzimeve dhe përfitimeve është që të kundërshtohen shpenzimet dhe përfitimet për ndonjë aktivitet, procedurë ose, në këtë rast, politikë publike. Gjatë vetë realizimit të hulumtimit, që nga fillimi janë vërejtur dy sfida të mëdha. **Fillimisht** shpenzimet, por shumë më shumë edhe efektet e lidhura me politikën publike, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor, janë të komplikuar për kuantifikim adekuat dhe preciz. Edhe pse ekzistojnë mënyra të caktuara në të cilat

mund të reflektojnë disa ndikime ndaj mjedisit jetësor dhe ndaj cilësisë së jetesës, ato paraqesin kategori shumë e gjerë dhe e ndjeshme dhe për to vetëm mund të bëhet tentim që në mënyrë adekuate të inkuadrohen në barazimin për përfitueshmërinë e politikës konkrete. **Sfida e dytë** me të cilën u ballafqua kjo analizë është fakti se një pjesë e madhe e aktiviteteve të parapara në planin kombëtar, i cili paraqiste bazë për të, janë ende të pparealizuara, madje çdo kundërshtim i efekteve të pritura të caktuara, përkundër shpenzimeve faktike të realizuara, jep, me të vërtetë, pasqyrim i shtrembëruar për dobishmërinë e saj. Duke punuar për politikën publike nga sfera e mjedisit jetësor, por edhe të çdo lexuesi të interesuar të kësaj analize, në qoftë se përqëndrohemi vetëm në atë përqindje të vogël të informatave rreth aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të arritura në periudhën 2009-2014. **Sipas të shpjeguarës, do të prezantojmë dy analiza për shpenzime dhe për përfitime:**

1. Analizë në afat të gjatë, në qoftë se politika do të realizohej në tërësi (2009-2029) dhe
2. Analizë në afat të shkurtër për gjendjen faktike (2009-2014).

KONTROLL I SHPENZIMEVE TË PARAPARA DHE TË PLANIFIKUARA PËR REALIZIM TË QËLLIMEVE TË SHQYRTUARA TË POLITIKËS PUBLIKE

Në pajtueshmëri me Planin kombëtar për menaxhim të mbeturinave (Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, 2008), investimet e planifikuara kapitale të dedikuara për krijim të sistemit rajonal për menaxhim të mbeturinave të forta komunale, si pjesë e vendosjes së infrastrukturës teknike, përbëhen nga:

- ✓ **Investime në punime ndërtimore dhe ndërtim të deponisë së re**
 - Punime ndërtimore dhe përgatitje të sipërfaqes për deponinë e re për punë
 - Investim në infrastrukturën e deponisë, duke përfshirë menaxhim të ujit
 - Stacion pastrues për filtrim dhe ujëra të tjera të zeza
 - Instalim të grumbullimit të gazit aktiv deponues dhe paratrajtim
- ✓ **Investime në mbylljen e deponisë së jostandardizuar**
 - Sigurim i materialeve të nevojshme dhe punime ndërtimore për mbyllje të sipërfaqes së deponisë
 - Investim në menaxhim të ujit nga reshjet e shiut
 - Investim në sistem për grumbullim dhe në stacionin pastrues për ujëra të zeza
 - Instalim (me siguri) grumbullim të gazit pasiv deponues dhe lëshim
- ✓ **Shpenzime operative për funksionimin e deponive rajonale**
- ✓ **Investime në pajisjes për grumbullim/transport**

Duke u nisur nga shpenzimet e planifikuara në PKMM, por edhe sipas një pjese të informatave zyrtare të marra nga ana e komunave, siç është rasti me Probishtipin dhe me Rankovcën i ashtuquajturin rajon lindor, vihet në konkluzion se është planifikuar që mjetet të sigurohen nga ana e fondeve dhe mjeteve të BE-së, të cilat janë të dedikuara për vende në negociata parainkuadruese me Unionin (p.sh. fondet e IPA-s). Kjo posaçërisht është meritë e faktit se bëhet fjalë shpenzime kapitale jashtëzakonisht të larta për një vend në zhvillim si Republika e Maqedonisë, madje është tejet logjik kuptimi që të shfrytëzohen rrjedhat e mundshme të financimit. Për këtë arsye hipotezën vendosim në drejtim të asaj se këto investime nuk do të bëheshin drejtëpërdrejtë nga Buxheti i RM-së, gjegjësisht nga mjetet publike, madje, sipas kësaj, ato janë përfshirë në përlogaritjet tona për shpenzimet e planifikuara.

Kontroll i kalkulatorit përmbledhës për shpenzimet e planifikuara në afat të gjatë (2009-2029)

Aktivitetet	Afati kohor për realizim	Përfitimet e përgjithshme të planifikuara dhe projektuar për periudhë	Mënyra e llogaritjes
Shpenzime operative për funksionin të dy qendrace rajonale dhe Drislla e sendërtuar	2009-2029	7.694.190.920	Shpenzimet janë shfaqur si në PKMM. Informatat për valutat bazohen në lëvizjet historike dhe lëkundjeve të çifteve devizore EUR, në krahasim me MKD, për periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2015, është përdorur platforma për tregtim devizor dhe konvertim valutor – Oanda Për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2029 janë marrë të dhënat për valutën nga viti 2015.
Shpenzime operative për funksionim të 34 xa deponive të sanuara	2009-2014	977.974.080	
Shpenzime operative për transport për të dy qendrat rajonale dhe Drisllën	2009-2029	7.272.248.807	
Shpenzimet mesatare për neto-pagë * për të punësuarit në MMJPH në fazën e ardhshme	2015-2029	271.684.770	Deri në vitin 2015 janë paraparë shpenzime të përgjithshme për trajnim dhe për pagë në vlerë prej 6m euro gjithsej për gjashtë vitet, nga viti 2015 vazhdojmë me llogaritjet vetëm të pagës për 30 të punësuar.
Shpenzimet mesatare për neto-pagë ** për të punësuarit në qendrat rajonale për menaxhim të mbeturinave	2015-2029	375.662.950	Në PKMM janë paraparë gjithsej 50 të punësuar në të gjithë qendrat rajonale dhe si shpenzim është paraparë edhe paga e rojektuar, për vitet pas ndërtimit të tyre të paraparë sipas PKMM-së.
Shpenzimet e përgjithshme që do të mbulohehin nga mjete publike		16.591.761.527	

Investime në punime ndërtimore dhe ndërtim të deponive të reja	2009-2014	2.284.227.133	Shpenzimet janë shfaqur si në PKMM. Informatat për valutat bazohen në lëvizjet historike dhe lëkundjeve të çifteve devizore EUR, në krahasim me MKD, për periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2015, është përdorur platforma për tregtim devizor dhe konvertim valutor - Oanda Investimet për deponitë e tjera janë paraparë të paraqiten pas periudhës gjashtëvjeçare në PKMM. Për këtë periudhëvaluta është përlogaritur sipas kursit në vitin 2015. Me bërjen e të gjithë këtyre investimeve do të përfshiheshte i gjithë territori i RM-së dhe do të kompletohej çështje lidhur me deponitë.
Investime në mbylljen e deponive të jostandardizuara	2009-2014	838.978.867	
Shpenzime investuese në pajisje transportuese (për tre qendrat rajonale)	2009-2014	2.267.783.973	
Investime në punime ndërtimore dhe ndërtim të deponive tjera (40 për qind nga kapaciteti i nevojshëm)	2016-2020	2.083.560.800	
Shpenzime personale për të punësuarit në MMJPH në fazën fillestare nga gjashtë vite (pagë dhe trajnime)	2009-2014	367.436.000	
Shpenzime të përgjithshme që do të mbuloreshin nga donacione dhe nga shfrytëzimi i fondeve **		7.841.986.773	

* Është marrë neto-paga sipas viteve nga ESHS (2009-2014), është bërë projeksion përmes shkallës së rritjes në vlerë prej 4,91 (e cila është pasqyrim i kushteve të ndryshme dhe krizave politike dhe ekonomike dhe vite të zgjedhjeve) për vitet e tjera

** Këto shpenzime nuk hyjnë në kalkulimin e mëtejshëm

KONTROLL I PËRFITIMEVE POTENCIALE NË QOFTË SE DO TË REALIZOHESHIN NË TËRËSI QËLLIMET E SHQYRTUARA TË POLITIKËS PUBLIKE

Mbrojtja e mjedisit jetësor paraqet një prej çështjeve kyçe që duhet ta tangojnë shoqërinë tonë të përgjithshme, posaçërisht duke pasur parasysh atë që çdo aktiviteti ynë, pozitivisht ose negativisht reflekton në rrethinën tonë, cilësinë e të jetuarit, në gjeneratat e tanishme, por edhe më shumë tek gjeneratat e ardhshme. Nga kjo arsye, vetë fakti se pasojat nga aktivitetet e kësaj politike publike do të paraqisnin përmirësim të cilësisë së ajrit, tokës së punueshme, si dhe të ujërave, i bënë të pavlerësueshëm. Si përfitime kryesore, ekologjike dhe sociale nga kjo politikë publike, më konkretisht nga pikat nga plani kombëtar, të cilët janë lëndë e kësaj analize, ndahen:

- Ulje të ndikimeve ndaj ajrit dhe ndaj ujërave që shkaktohet nga deponimi jo i drejtë dhe nga mënyra tjera joadekuate të menaxhimi të mbeturinave, si dhe nga deponitë e egra
- Ulje të emetimeve të gazrave që shkaktojnë efekt të kopshtit të qelqtë nga deponitë

- Rritje të sasive të grumbulluara nga mbeturinat e krijuara të përgjithshme duke ndërmarrë investime në kapacitete për grumbullim dhe për transport të mbeturinave, me mbështetje nga strukturat organizuese dhe zbatim të parimit “ndotësi paguan” dhe parimin për gjegjësi të oseduesit të mbeturinave
- Rritje të punësimit në sektorin privat me formim të organizatave – veprues me fraksione të caktuara të mbeturinave, si mbeturina nga paketimi, bateri dhe akumulatorë jashtë përdorimit dhe mbeturina elektronike
- Mundësim i resurseve alternative dhe energjenseve përmes përpunimit të disa llojeve të mbeturinave
- Ulje të shpenzimeve sociale nga emetimi i gazrave që shkaktojnë kopsht të qelqtë përmes përpunimit dhe reciklimit të mbeturinave të përziera, në vend të deponimit të tyre
 - **Shpenzimet sociale (Social costs of CO2 – SC-CO2)** sipas Agjencisë për mbrojtje të mjedisit jetësor të SHBA-së, por edhe të agjencive tjera federale, janë përpjekje për vlerësim gjithëpërfshirës të dëmeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike ndaj neto-produktivitetit agrar, shëndetit të njeriut, dëme të pronave nga rreziku i rritur nga përmytje, si dhe ndryshime në shpenzimet e sistemit energjetik, siç janë ulur shpenzimet për ngrohje dhe janë rritur shpenzimet për ftohje. Në pajtueshmëri me publikimin e punuar nga Agjencia (United States Environmental Protection Agency, 2013), ato janë vlerësim i dëmeve ekonomike të lidhura me dëmet me rritje të vogël në emetimin e dioksid karbonit (CO2) (e matur përmes tonëve, në vitin e dhënë), por edhe të vlerës të dëmeve të shmangura përmes uljes së saj të vogël. Edhe pse shpenzimet sociale si tregues nuk i përfshijnë të gjithë aspektet nga emetimi i gazrave që shkaktojnë efekt të kopshtit të qelqtë, për shkak të vështirësisë në matjen dhe projektimin e tyre, megjithatë paraqet vegël e dobishme për matje të përfitimeve nga zvogëlimi i emetimit të gazrave që shkaktojnë efekt të kopshtit të qelqtë.
- Rritje të të ardhurave në Buxhetin e RM-së përmes:
 - taksa për leje për veprim, grumbullim, përpunim, taksa për eksport;
 - tatime të fitimit të paguara nga ana e kompanive ekzistuese dhe të ardhshme që do të punojnë në grumbullimin, përpunimin dhe reciklimin fraksioneve adekuate të mbeturinave;
 - përveç tatimeve, me rëndësi të posaçme në këtë pjesë janë edhe donacionet nga ana e vepruesve kolektivë për rrjedhat e posaçme të mbeturinave deri tek komunitat, të cilët në këtë moment nuk kanë mundësi që të vlerësohen.
- Rritje të jetëgjatësisë së shfrytëzimit të deponive rajonale përmes selektimit dhe largimit të një pjese të mbeturinave të deponuara me qëllim të reciklimit të tyre.

Megjithatë, gjatë përpunimit ë]të një analize për shpenzimet dhe për përfitimet në sferën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, posaçërisht duke pasur parasysh atë se kjo politikë publike në pjesën më të madhe i vendos fillimet dhe bazat e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave në vend, vlerësimi dhe kuantifikimi i përfitimeve iu

nënshtrohet një numri të madh të pasigurive, vlerësime dhe projeksione në bazë të studimeve të bëra për arsyeshmërinë ekonomike dhe përvojat e vendeve tjera në këtë sferë.

Është e rëndësishme që të theksohet se letra, qelqi dhe plastika (por edhe druri, mbeturinat metalike dhe të tjera) mund të krijohen nga paketime të ambalazuara (dhe

Kontroll i kalkulatorit përmbledhës me përfitimet pritura në afat të gjatë (2009-2029)

Aktivitete	Afati kohor për realizim	Përfitimet e përgjithshme të planifikuara dhe projektuar për periudhë	Mënyra e llogarritjes
Të ardhura të ndërmarrjeve komunale nga taksat e amvisërive	2009-2029	2.163.382.500	Numri i banorëve dhe numri mesatar i amvisërive në vend është përlogaritur sipas (ESHS 2014). Është marrë shumë globale mesatare për shërbime komunale për amvisëri në vlerë prej 250 den. (për periudhën deri në vitin 2014), ndërsa nga viti 2015 shuma rritet në 400 den. Në pajtueshmëri me parashikimet për rritje të nevojshme të taksave të popullsisë në PKMM.
Të ardhura potenciale nga grumbullimi i letrës nga mbeturina komunale, e cila do të shitej që të recikohet	2009-2029	31.999.998	Të dhënat për mbeturina të krijuara komunale 2009-2014 janë marrë nga ESHS (Mbeturina komunale 2009;2010;2011;2012;2013;2014), për periudhën 2015-2029 janë marrë të dhëna nga viti 2014.
Të ardhura potenciale nga grumbullimi i plastikës nga mbeturina komunale, e cila do të shitej që të recikohet	2009-2029	42.666.664	Fraksionet e përmbajtura në mbeturinat komunale sipas Bankës Botërore (URBAN DEVELOPMENT SERIES – KNOWLEDGE PAPERS, 5 Waste composition,faqe19) (e shfaqur në përqindje për vendet me varfëri të mesme në zhvillim siç është RM-ja janë si vijojnë: Mbeturina organike – 59%, Letër – 9%, Plastikë – 12%, Qelq – 3%, Metal – 2%, Të tjera – 15%. Pasiqë janë marrë sasitëpër çdo fraksion në veçanti është përlogatuar çmimi për qelq, plastikë dhe për letër të shitura në recilim, e cila rritet gradualisht deri në maksimum 80 për qindpër secilin fraksion.
Të ardhura potenciale nga grumbullimi i qelqit nga mbeturina komunale, e cila do të shitej që të recikohet	2009-2029	10.666.666	Çmimi i materialeve adekuate sekondare sipas (Eurostat 2016); kursi i euros në kundërvlerë me denarin sipas (Oanda 2016)

Ulje të shpenzimeve sociale nga emetimi i gazrave që shkaktajnë efekt të kopshtit të qelqtë nga mbeturina të përpunuara komunale, në vend të vetëm deponimit të tyre	2009-2029	17.343.281.631	Sasitë e mbeturinave të përpunuara komunale/mbeturina nga paketimi (tons) janë shumëzuar me 2,79 që të fitohet sasia e gazrave që shkaktajnë kopsht të qelqtë (metric tons) sipas (ERA 2016), pastaj kjo shumë është shumëzuar me projeksionin për shpenzime sociale sipas viteve (të dy përlllogaritjet janë të (ERA 2016); kurs i dollarit në kundërvlerë të denarit (Oanda 2016)
Ulje të shpenzimeve nga emetimi i gazrave që shkaktajnë efekt të kopshtit të qelqtë nga mbeturina të përpunuara nga paketimi, në vend të vetëm deponimit të tyre	2011-2029	3.888.317.203	
Të ardhura potenciale nga grumbullimi nga letra nga mbeturina nga paketimi, e cila do të shitej që të riciklohet	2011-2029	4.366.264.760	Çmimi i materialeve adekuate sekondare sipas (Eurostat 2015); kursi i euros në kundërvlerë të denarit sipas (Oanda 2016); Sasitë e krijuara nga MP 2011-2015 janë marrë nga Programi për mbeturina nga paketimi i MMJPH (2011) faqe 4, ndërsa në periudhën 2016-2029 janë projektuar sasi në pajtueshmëri me shkallën mesatare të rritjes prej tre për qind në vitet paraprake. Përqindje të përpunimit: 2011-5% mbeturina të ricikluara; 2012-10%; 2013-19%; 2014-28%; 2015-34% në pajtueshmëri të Programit për mbeturina nga paketimi i MMJPH (2011) faqe 11-12. Për periudhën kohore 2016-2029 përqindja e riciklimit është paraparë në pajtueshmëri me nenin 35 nga Ligji për mbeturina nga paketimi, dhe rritet për 5% në çdo dy vite deri në maksimum 80%.
Të ardhura potenciale nga grumbullimi i plastikës nga mbeturina nga paketimi, e cila do të shitej që të riciklohet.	2011-2029	8.102.274.920	
Të ardhura potenciale nga grumbullimi i qelqit nga mbeturina nga paketimi, e cila do të shitej që të riciklohet	2011-2029	649.345.468	
Gjithsej		36.598.199.811	

me këtë konsiderohen si mbeturina nga paketimi), por edhe nga aktivitetet e përditshme të qytetarëve, që do të konsiderohej për mbeturina komunale nga amvisëritë. Gjithsesi, ekziston mundësi që të ketë mbyllje midis të ardhurave të projektuara nga njëra rrjedhë dhe nga rrjedha tjetër të këtyre fraksioneve të mbeturinave, posaçërisht për shkak të asaj që nga të dhënat për mbeturina të krijuara të projektuara nga paketimi, nuk mund të merret saktë se sa për qindje do të përfundonte në mbeturinat komunale të krijuara nga amvisëritë dhe nga personat juridik, të cilat pastajmerren nga NPK.

Si efekte plotësuese që janë marrë parasysh, por për të cilët nuk ishte e mundur që të bëhet kalkulim adekuat dhe kuantifikim i saktë janë edhe punësimet e reja në sektorin privat lidhur me fazat e ndryshme të manxhimit të fraksioneve të posaçme të mbeturinave, grumbullimi i tyre, transporti, përpunimi, reciklimi dhe shitja. Këto efekte në mënyrë plotësuese do të mund të shumëzoheshin në qoftë se merren parasysh taksat ndaj shtetit, të cilët do t'i paguanin këto subjekte në formë të tatimeve të fitimit, taksave për licenca dhe leje dhe të ngjashme. Ndoshta përfitimi më afatgjatë do të paraqisnin investimet e vepruesve kolektiv në infrastrukturën adekuate.

Kategoria që duhet të merret parasysh, por e cila është pothuajse e pamundur që në mënyrë adekuate të kuantifikohet dhe projektohet për momentin, paraqet edhe eksporti i rrjedhave të mbeturinave të posaçme. Pikërisht, për këto qëllime do të nevojitej analizë tërësisht e veçantë. Një prej aspekteve që do të kishte ndikim të madh në lëvizjen e tregtisë me mbeturina paraqet edhe drejtimi në të cilin do të vazhdonte të zhvillohet kjo sferë në të ardhmen, gjegjësisht se nëse vendi do të vendosë ta promovojë reciklimin e mbeturinave në territorin vendor, duke ndërmarrë aktivitete në drejtim të inkurajimit të sektorit privat që të udhëzohet në këtë sferë, ose, madje, zgjidhja e mbeturinave do të kërkohej në eksportin e tyre, mbetet të shikohet. Ndoshta për një periudhë të caktuar, Maqedonia do ta ndiqte shembullin e suksesshëm të Skandinavisë në drejtim të zhvillimit të kësaj industrie, duke e bërë një prej pjesëve kryesore të BPV-së vendore.

Neto-vlera e tanishme totale, siç mund të shihet edhe nga kalkulatori i bashkëngjitur, arrin 3.826.610.489 MKD, e përlogaritur për periudhën nga 20 vite (2009-2029), që në tërësi e konfirmon hipotezën tonë.

Një prej efekteve më të rëndësishme nga ndryshimet e reja ligjore është ajo që lidhur me rregullimin e deponive dhe moslejtim të mbeturinave të përziara të deponuara, e përbërë edhe nga një pjesë e MBA, mbeturina elektronike, goma të vjetra dhe të ngjashme, që paraqiste kanosje e madhe për shëndetin tonë. Marrë konkretisht, deponimi i mbeturinave elektronike dhe të MBA së bashku me mbeturinat e tjera të forta komunale paraqiste rrezik i madh për shkak të sasive të metaleve helmuese dhe të dëmshme që lëshohen në tokë me shkatërrimin e tyre. Sipas përvojave të deritanishme, me reciklim të baterive kursehen energjia dhe resurse dhe zvogëlohen shpenzimet që janë të nevojshme në degë të ndryshme industriale. Kursimi i energjisë përmes materialit të ricikluar nga pajisja elektrike dhe elektronike (MPEE), e cila përmban lloje të ndryshme të baterive, është prezantuar në tabelën e ardhshme Jovanovski, (2014).

Materiali	Alumini	Bakri	Hekuri/Çakalli	Plumbi	Zingu
Kursimi i energjisë (%)	95	85	74	65	60

ANALIZË PËR SHPENZIMET DHE PËR PËRFITIMET PËR SHPENZIMET E REALIZUARA DHE PËR EFEKTET E E ARRITUR PËR PERIUDHËN 2009-2014

SHPENZIMET E REALIZUARA

Krahas analizës së bërë të shpenzimeve dhe përfitimeve potenciale, kemi bërë hulumtim plotësues lidhur me realizimin faktik tek ata që të mund të vlerësohet efekti real. Lidhur me **harmonizimin me rregullativën ligjore të BE-së**, konkluzioni ynë është se në një pjesë të madhe është realizuar, megjithatë duhet të ekzistojë edhe realizimi i saj dhe zbatim real. Konsiderojmë se problem gjatë realizimit paraqitet në qasjen e pamjaftueshme reale gjatë përpilimit të strategjisë dhe planeve dhe për shkak të vetëdijes dhe aktivitetit fillimisht të shtetit, ndërsa me këtë edhe të qytetarëve në këtë sferë. Zbatimi i legjislacionit duhet të ndiqet dhe të bëhen ndryshime adekuate pas analizave të bëra terrenike me personat e involvuar, vepruesit kolektiv, qytetarët dhe, përfundimisht, të bëhet krahasim adekuat me përvojat e vendeve në BE. Konsiderojmë se në ligjet, posaçërisht ato për MP, MBA dhe MPEE, duhet saktësisht të parashtrihen disa qëllime në infrastrukturë nga ana e komunave, së bashku me vepruesit, ndërsa me këtë edhe saktësisht të përcaktohen rolet e të gjithë institucioneve. Më tej, me ndjekjen e zhvillimit të ngjarjeve mund të mendohet edhe për vendosje të dispozitivve në atë mënyrë që për ndotësit e mëdhenj për mbeturina të caktuara do të krijohej donacion minimal që duhet ta realizojnë për përmirësim në këtë sferë, krahas bashkëpunimit me vepruesit kolektiv. Përkushtueshmëria e institucioneve shtetërore duhet të theksohet për shkak se pa shërbime të fuqishme inspektuese dhe inspektorë të trajnuar për mjedisin jetësor, nuk është i mundur zbatimi në terren.

Si shpenzime të realizuara i morëm shpenzimet për neto-paga të paguara në sektorin për menaxhim të mbeturinave, i cili ka tetë të punësuar, sipas të dhënave nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, për gjashtë vitet e shqyrtuara, duke e marrë parasysh neto-pagën mesatare për vitin adekuat, në pajtueshmëri me të dhënat nga Enti Shtetëror për Statistikë. Këto shpenzime janë në vlerë të përgjithshme prej **12.343.200 MKD** për periudhën për gjashtë vite.

Lidhur me uljet e ndikimeve të mjedisit jetësor, përmes nënqëllimeve të përzgjedhura adekuate, nga informatat me të cilat disponojmë nga më shumë burime zyrtare dhe jozyrtare, deri tani është përgatitur një pjesë e dokumentacionit ose dokumentacioni i plotë i nevojshëm për funksionim të së dy deponive të parapara rajonale, ndërsa sendërtimi i deponisë ekzistuese "Drislla" ende nuk është realizuar tërësisht. Kjo tregon se shpenzimet e parapara për investime në këto tre objekte janë të porealizuara në tërësi, ose, më saktësisht, janë në fillim të realizimit, edhe pse për to është parashikuar që të përfundojnë deri në vitin 2015. Për deponinë "Drislla" është bërë edhe studim i hollësishëm për arsyeshmërinë ekonomike nga ana e Korporatës financiare

ndërkombëtare – pjesë e grupacionit të Bankës Botërore (IFC), e cila ka sistemuar mjete për shërbime këshilldhënëse përmes programit të saj për menaxhim të integruar të mbeturinave të forta, i financuar me mjete nga donatorë. IFC do t'i ndihmojë "Drislla"-s që të rehabilitohet dhe të përmirësohet puna e deponisë sipas studimit për arsyeshmëri ekonomike (MacDonald Ltd 2011).

Në mungesë të informatave precize për mjetet e sakta të shpenzuara në periudhën e analizuar për këto qëllime, por edhe për shkak të pasqyrimit jo të hollësishëm të paragrafëve në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë, është bërë vlerësim i shpenzimeve të realizuara duke përdorur përqindjen e realizueshmërisë së përgjithshme të buxhetit të MMJPH-së, i llogaritur në bazë të shkallës së planifikuar për investime në mbrojtjen e mjedisit jetësor. Këto shma janë marrë me rezervë, duke pasur parasysh se nuk ekziston specifikacion i hollësishëm që u dedikohen në buxhet ose në llogarinë përfundimtare të RM-së, por edhe për shkak të asaj që deri në momentin e punimit të këtij teksti nuk është marrë përgjigje zyrtare nga ana e Ministrisë së Financave dhe nga MMJPH-ja. Shuma e përgjithshme e këtyre shpenzimeve për gjashtë vitet është **222.267.850 MKD**.

Duke pasur parasysh ende organizimin ekzistues komunal të ndërmarrjeve komunale për grumbullim dhe për deponim të mbeturinave të forta komunale të deponive komunale, si shpenzime u imponuan edhe shpenzimet që i kanë ndërmarrjet komunale publike, të cilat ofrojnë shërbime për grumbullim të mbeturinave komunale, ndërsa në të cilët janë të përfshira edhe shpenzimet transportuese dhe shpenzimet për të punësuarit. Duke marrë parasysh faktin se informatat me të cilat disponojmë u dedikohen një periudhe kohore tejet të shkurtër (2009-2013), u përjashtua mundësia për interpolacion për projeksion të shpenzimeve në vitin e ardhshëm, si dhe për shkak të supozimit se ndërmarrjet komunale nuk e ndryshojnë vëllimin e punës së saj në mënyrë drastike nga viti në vit, e morën të dhënën nga viti i fundit që është në dispozicion. Në mënyrë plotësuese i morëm edhe shpenzimet për investime në automjete për vitet 2012/2013 nga analiza e Shoqatës së dhënësve të shërbimeve komunale të RM – ADKOM (2014). Të dalurat e përgjithshme operative janë në vlerë prej **14.333.662.975 MKD**, ndërsa shpenzimet investuese janë **68.239.063 MKD**.

Sipas përgjigjeve të 25 nga gjithsej komunat e kontaktuara (përmes kërkesës zyrtare për qasje deri te informatat me karakter publik) në nivel të RM-së në pyetjen për shpenzimet e realizuara nga ana e tyre, lidhur me sanimin/mbylljen e deponive komunale dhe mbyllje të deponive të egra, një pjesë u përgjigjën se kjo sferë është nën kompetencë të NPK-së e obliguar për komunën adekuate ose, madhe të dalurat e realizuara janë mbuluar nga BE-ja. Të dhëna konkrete për të dalurat e vetë komunës morëm nga komunat Makedonski Brod, Strugë, Rosoman dhe Bosillovë, Probishtip, Gradsko, Novac, Bogdanc dhe Veles për periudhën 2009-2014. Ato kushtojnë gjithsej **30.534.105 MKD**. Në pajtueshmëri me informatat e marra, deri më tani nuk është hapur asnjë deponi rajonale, ishte pjesë plotësuese e pyetjes së parashtruar deri te komunat.

Në fund, si të fundit, ndoshta indirekte, por megjithatë jo më pak të rëndësishme, janë marrë shpenzimet sociale nga emetimi i gazrave që shkaktojnë efekt të kopshtit të

qelqtë nga deponitë nga mbeturinat e deponuara të përziëra komunale, që nuk janë recikluar. Këto shpenzime janë përlogaritur në bazë të së të dhënave nga ESHS për mbeturina të forta të krijuara dhe grumbulluara komunale, e cila është deponuar dhe është **5.824.382.943 MKD**. Kjo përlogaritje është shfrytëzuar disa herë dhe është shpjeguar më lartë, si për shpenzim nga menaxhimi joadekuat i mbeturinave, ashtu edhe si efekt gjatë përpunimit ose reciklimit të tyre. Krahasuar me vende nga BE-ja, sipas të dhënave të Eurostatit për, për shembull Gjermania, përqindja e mbeturinave të përgjithshme të deponuara përkundër atyre të krijuara është 18 për qind, ndërsa për Maqedoninë e njejta përqindje është pothuajse 99.

PËRFITIMET E ARRITURA

Përfitimet kryesore i shohim në disa sfera, midis të cilëve në periudhën e kaluar janë formuar shtatë kompani që veprojnë me fraksionet adekuate të mbeturinave, prej të cilëve katër me mbeturina nga paketimi, dy me MBA dhe mbeturina elektronike (prej të cilave njëra është hapur në vitin 2015) dhe një që punon vetëm me MBA. Ato janë efekt të shumëfishtëndaj ekonomisë, në fillim përmes krijimit të vendeve të reja të punës, por edhe përmes taksave publike për leje të nevojshme për veprimtarinë, donacionet (kontejnerë, automjete dhe pajisje tjera), të cilët ata i japin si trupa jopërfitues nga të ardhurat e realizuara dhe ngjashëm. Informatat adekuate për vepruesit janë, në një pjesë të marra personalisht nga ata, por për të gjitha janë siguruar edhe informata zyrtare nga raportet nga puna e tyre të dorëzuara në regjistrin qendror të RM-së për periudhën nga marrja e lejeve të tyre, madje përfundimisht me vitin 2014. Periudha kohore në të cilën ata ekzistojnë dhe punojnë me të vërtetë është e shkurtër, por, megjithatë, tregojnë progres nga viti në vit në drejtim të grumbullimit të një përqindjeje më të madhe nga lloji adekuat i mbeturinave. Më poshtë pason parysim tabelar i përfitimeve të përmendura.

Përfitimet	Vepruesit me mbeturina nga paketimi	Vepruesit me mbeturina elektrike dhe MBA
Taksat për të punësuarit (burimi: RQM)	24.591.986	914.516

Përfitimet	Taksat për leje për trajtim dhe për mbeturina të deponuara	Taksat për leje për transport të mbeturinave të parrezikshme
Gjithsej	1.863.000	1.944.000
Përlogaritja	Numri i lejeve të dhëna për periudhën 2009-2014 *9.000 MKD (shuma për një leje)	Numri i lejeve të dhëna për periudhën 2009-2014 *12.000 MKD (shuma për një leje)

Si edhe një efekt paraqiten edhe të ardhurat e rregullta që i krijojnë NPK për grumbullim të mbeturinave komunale nga taksat e paguara komunale nga ana e qytetarëve sipas analizës së Shoqatës së dhënësve shërbimeve komunale të RM – ADKOM (2014). Të ardhurat e përgjithshme janë **16.981.984.856 MKD**.

Efekt plotësuese mbi buxhetin e RM-së, por edhe mbi vetë BPV-në paraqet edhe rritja e eksportit të disa fraksioneve të mbeturinave, e përlogaritur sipas tarifave adekuatë doganore nga nomenklatura doganore, e miratuar nga Drjtoria Doganore e RM-së, duke i përfshirë mbeturinat nga masat plastike, letra dhe kartoni, qelqi, si dhe MBA. Në pajtueshmëri me të dhënat nga ESHS, shuma për periudhën 2009-2014 është gjithsej **1.859.253.847 MKD**. Krahasuar me vitin 2009, eksporti i mbeturinave në vitin 2014 shënon rritje prej pothuajse 300 për qind, që flet për potencialin për rritje të kësaj fushe.

Në fund, si përfitimet në mënyrë të pashmangshme i marrim edhe uljen e shpenzimeve sociale nga emetimi i gazrave që shkaktojnë efekt të kopshtit të qelqtë për shkak të asaj që është mbeturina (mbeturina komunale dhe mbeturina nga paketimi) i recikluar përkundër atij të deponuar. Kjo është bërë duke përdorur të njejtën përlogaritje për shpenzime sociale nga emetimi i ekuivalentëve të dioksid karbonit (CO₂) nga më lartë, në bazë të të dhënave të marra nga raportet zyrtare të MMJPH për të gjithë gjashtë vitete lidhur me mbeturinat e forta komunale, si dhe për vitin 2011 dhe për vitin 2012 për mbeturina të recikluara nga paketimi, ndërsa për mbeturina nga paketimi pjesa tjetër është marrë nga nga vetë vepruesit dhe deklaratat e tyre, por një pjesë e vogël edhe nga burime jozyrtare. Pa dallim të asaj që shqyrtohet edhe menaxhimi i MBA dhe të mbeturinave elektronike, ky kalkulim nuk përshtatet për këtë lloj të mbeturinave, madje nga atje është lënë anash. Megjithatë në mënyrë plotësuese janë marrë edhe të dhëna mesatare pr plastikën e grumbulluar dhe të përpunuar në vitin 2011 (e shfrytëzuar si shumë edhe për vitin 2009 dhe për vitin 2010) dhe në vitin 2012 (e shfrytëzuar si shumë edhe për vitin 2013 dhe 2014). Uljet e përgjithshme të shpenzimeve sociale nga gazrat që shkaktojnë efekt të kopshtit të qelqtë në bazë të këtyre tre shkallëve është **103.416.800 MKD**.

Në pajtueshmëri me kontributin nga kalkulatori për shpenzimet e realizuara dhe fektet e realizuara në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2014, mund të shihet se rezultati i shfaqur në neto-vlerë të tanishme është **(- 1.121.470.819) MKD**. Me këtë e konfirmojmë hipotezën e vendosur paraprake se praktika momentale e mbeturinave është joefikase dhe joefektive. Për shkak të së theksuarës, konsiderojmë se çfarëdo lloj tentimi për projeksion të përfitimeve të ardhshme nga ajo që është realizuar deri më tani do të ishte tejet e pakuptimtë dhe e patërësishme, posaçërisht duke pasur parasysh se tanimë ekziston politikë publike për sferën, por mungon realizimi i saj i plotë dhe në kohë, përfitimet potenciale të së cilave, përkundër investimeve të nevojshme, janë prezantuar në pjesën e analizës për shpenzimet dhe për përfitimet dhe efektet potenciale në afat të gjatë.

REKOMANDIME

Në këtë pjesë do të përpiqemi të japim një set të shkurtër të masave dhe rekomandimeve që do të duhet të paraqesin rregullore kur në pyetje është menaxhimi i mbeturinave në RM.

- Jorastësisht fillojmë me rekomandimin që paraqet edhe konkluzion kryesor nga e gjithë analiza e punuar, gjegjësisht mjedisi jetësor duhet të vendoset si prioritet i lartë në politikën e pushtetit ekzekutiv dhe lokal, duke i ndjekur shembujt e vendeve të zhvilluara ekonomike, duke filluar nga vendet që janë anëtare të BE-së.
- Lidhur me rekomandime dhe sfidat me të cilat u ballafaquam gjatë punimit të kësaj analize, duhet të theksojmë se duhet të ketë transparencë më të madhe të të dhënave dhe përgjegjshmëri të institucioneve publike. Përmes shfrytëzimit të së drejtës për qasje deri te informatat me karakter publik, në afatin e paraparë morëm përgjigje nga komuna: Pllasnicë, Shtip, Probishtip, Rosoman, Dojran, Demir Hisar, Llozovë, Demir Kapi, Bosillovë, Resnjë, Dellçevë, Berovë, Krushevë, Petrovec, Ohër, Makedonski Brod, Ilinden, Çashkë, Strugë, Çuçer Sandevë, Rankovcë, Veles, Novac, Bogdanc dhe Gradsko, të cilëve u jemi falënderues për bashkëpunimin. Ndërsa, informatat e kërkuara me karakter publik nga komunat e tjera në nivel të RM-së dhe Qytetin e Shkupit, si dhe MMJPH dhe Ministria e Financave, nuk i morëm.
- Me rëndësi të veçantë është që të ekzistojë gjithëpërfshirje më të madhe të ardhshme, hollësi, saktësi dhe standardizim të të dhënave, gjegjësisht të dhënat e dhëna nga burime zyrtare duhet të jenë identike me ato që janë përpunuar në raportet e institucioneve kompetente. Në raportet për cilësinë e mjedisit jetësor të MMJPH-së për një vit theksohen numra nga vit tjetër dhe ngjashëm, që paraqet problem gjatë realizimit të këtij lloji të analizave.
- Kjo nën pikë, ndoshta, edhe më e rëndësishme për ne si organizatë, si dhe për shëndetin e njerëzve dhe për gjithë natyrën dhe rrethinën, ndërsa i dedikohet realizimit të plotë të planit të bërë për menaxhim të mbeturinave dhe për realizim të standardeve të parapara. Gjegjësisht, sugjerojmë që në afat sa më të shkurtër të mundur të bëhet sanimi dhe mbyllja e nevojshme e deponive të pastandardizuara, të hapen deponi të reja të standardizuara rajonale që shpenzimet të mod jenë më të larta. Në esencë, nga gjithçka që është prezantuar deri më tani, mund të konkludohet se PKMM nuk është tërësisht i zbatueshëm dhe realizueshëm, edhe pse periudha për të ka përfunduar. Produktiviteti i këtillë i pamjaftueshëm e loçojmë në faktin se përvojat e deritanishme nuk tregojnë theksim të mjaftueshëm dhe dhënie prioritet mjedisit jetësor dhe politikës për të në përgjithësi, as nga ana e strukturave të kaluara qeveritare dhe institucionet adekuate, e as nga ana e industrisë, personave juridik dhe qytetarët, si palë drejtëpërdrejtë të involvuar. Mënyra e vetme e zgjidhjes së këtij problemi është në qoftë se i kushtohet vëmendje dhe angazhim adekuat në këtë sferë, në të kundërtën marginalizimi i saj dhe vendosja e përhershme e sferave tjera shoqërore me çdo çmim para ekologjisë do të çonte deri në dëme katastrofike në natyrë dhe në shëndetin e njerëzve.

- Nevojitet investim në kapacitete përpunuese që do të sillnin të ardhura financiare. Por, për shfrytëzimin e tyre maksimal është e domosdoshme vendosje e sistemit të selektimit primar të mbeturinave komunale nga vetë amvisëritë, që do të arrihej përmes vendosjes së infrastrukturës adekuate (kontejnerë separativ, kontejnerë nëntokësor separativ dhe automjete) dhe ngritje të vetëdijes publike me edukim adekuat të sektorit civil.
- Në mënyrë të pashmangshme nga e prezantuara lidhet edhe nevoja dhe obligimi për revision të realizimit të planit për menaxhim të mbeturinave, në afatin e paraparë prej tre vitesh në pajtueshmëri me PKMM-në për periudhën 2016-2022..
- Këtu e shfrytëzojmë edhe mundësinë që të theksojmë në nevojën për pastrim të rregullt të deponive të egra dhe për parandalim nga krijimi i sërishëm i tyre për shkak se, në të kundërtën, kemi vetëm ndotje të rrethinës dhe lëshim të grimcave të dioksid karbonit për shkak të deponimit të mbeturinave komunale dhe shpenzime shtesë për mbyllje të deponive ilegale. Që të sigurohet grumbullim i rregullt i mbeturinave nga të gjitha vendbanimet, për Qytetarët e mjediseve rurale që të mos e dëmtojnë veten e tyre me largimin jot të rregullt të mbeturinave. Një pjesë e madhe e komunave u përgjigjen se këtë problem e trajtojnë përmes aksioneve të realizuara për pastrim, të organizuara, kryesisht, nga sektori joqeveritar civil. Theksojmë se këto aksione do të duhet të paraqesin mënyrë shtesë për ngritje të ndërgjegjes së qytetarëve, e jo mënyrë primare për ballafaqim me këtë problem të madh ekologjik.
- Më tej, propozojmë që shembulli pozitiv me Ligjin për mbeturina nga paketimi, Ligjit për mbeturina të baterive dhe akumulatorëve, si dhe Ligji më i ri për mbeturina elektronike, të zbatohet si parim i “ndotësi paguan”, të pranohet si ndërgjegje publike dhe ky parim të zbatohet tek çdo lloj i mbeturinave. Të përforcohen inspektionet tek personat juridik – “ndotës” dhe vetë vepruesit dhe të ndikohet ndaj selektimit tek vetë qytetarët për këto lloje të mbeturinave, si dhe për të tjerat.
- Janë të domosdoshme edhe investime nga ana e vetë komunave, sa i përket infrastructures për selektim të llojeve të caktuara të mbeturinave me ç’rast vetëm do të rritet ndikimi edhe pasojat negative nga dispozitat e kiratuara ligjore. Edhe krahas asaj që vepruesit kolektiv kanë për qëllim që mjetet e fituara nga ndotësit me nënshkrim të marrëveshjes i riinvestojnë sërish në përmirësim të menaxhimit të mbeturinave, nuk mund të pritët se këta trupa duhet t’i dorëzojnë të gjithë shpenzimet, për arsye se investimet që pasojnë janë të rëndësishme dhe duhet të mbulohen me forcë të bashkuar.

KONKLUZIONI

Shoqëria në Maqedoni kohëve të fundit po bëhet më e brengosur për problemet në mjedisin jetësor, por sapo duhet të priten ndryshime esenciale në qëndrimet dhe sjelljet shoqërore që të arrihen përmirësime më të mëdha dhe të qëndrueshme në menaxhimin e mbeturinave. Republika e Maqedonisë për momentin po ballafaqohet me numër të madh të problemeve në sferën e menaxhimit me mbeturina dhe ende nuk zbatohet sistemi i integruar dhe i qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave. Menaxhimi i mbeturinave është sfidë e madhe ekologjike në vend, pikërisht për shkak të mungesës së infrastructures adekuate. Menaxhmenti i mbeturinave në BE duhet të merret si shembull për shtetin tone. Për shembull, në Gjermani procesi i është degë prosperuese në industri. Në vit, gjermanët përfitojnë edhe 200 miliardë euro nga reciklimi. Kjo degë ekonomike në vit rritet për 14 për qind dhe siguron punë për rreth 250.000 persona. Ekzistojnë rezultate pjesërisht positive në afrimin e direktivave të BE-së, por për momentin ballafaqohemi me problem serioz në pjesën e zbatimit praktik.

Me rëndësi të veçantë është që investimet në menaxhimin e mbeturinave të analizohen si përfitim potencial ekonomik, e jo si mjete të investuara të pakthyeshme. Stimulimi i qytetarët dhe të sektorit afarist për reciklim, investim në pajisje për reciklim dhe hapje dhe lëshim në qarkullim të stacioneve të reja të specializuara për këtë dedikim do të thoshte ulje e përqindjes së mbeturinave të larguara, përfitime të larta financiare, kursim të resurseve, rezultate të konsiderueshme ekologjike dhe dhe përmirësim të cilësisë së jetesës.

Mjedisi jetësor duhet të paraqesë sferë që është më pak e politizuar, gjegjësisht aspak e politizuar. Këtu nuk bëhet fjalë për mënyrë të udhëheqjes së ndonjë politike dhe axhende, bëhet fjalë për, me të vërtetë, investime të mëdha, të cilat në afat të gjatë ofrojnë shumë përfitime dhe zhvillojnë industri të tëra, me të cilat përmirësohet mjedisi jetësor, ndërsa me të edhe cilësia e shëndetit të njerëzve. Përfundimisht, në qoftë se nuk ndërmerret qasje më serioze për përmbushje të së parashikuarës ligjore dhe të theksuar në dokumentet e tjera të ardhshme të punuara dedikuese, kjo do të paraqiste frenim të R.Maqedonië në procesin e kandidatit për vend-anëtar të BE-së.

"The environment, after all, is where we all meet, where we all have a mutual interest. It is one thing that all of us share. It is not only a mirror of ourselves, but a focusing lens on what we can become." - First Lady, Lady Bird Johnson

BIBLIOGRAFIA

- [1] Влада на Република Македонија (2008) *Стратегија за управување со отпад на Република Македонија (2008-2020)*.
- [2] Здружение на даватели на комунални услуги на РМ – АДКОМ (2014) *Анализа на состојбата во комуналниот сектор во Република Македонија*.
- [3] Јовановски, А. (2014) *Бањерии – ојасносї или можносї? Зашиѓега на ресурси преку рециклирање бањерии*. Фондација Конрад Аденауер во Република Македонија.
- [4] Министерство за животна средина и просторно планирање (2008) *Национален план за управување со отпад (2009-2015) на Република Македонија*.
- [5] Министерство за животна средина и просторно планирање (2010) *Годишен извештај од обработени податоци за квалитетот на животната средина за 2009 година*.
- [6] Министерство за животна средина и просторно планирање (2011) *Годишен извештај од обработени податоци за квалитетот на животната средина за 2010 година*.
- [7] Министерство за животна средина и просторно планирање (2011) *Програма за управување отпад од пакување*.
- [8] Министерство за животна средина и просторно планирање (2012) *Годишен извештај од обработени податоци за квалитетот на животната средина за 2011 година*.
- [9] Министерство за животна средина и просторно планирање (2013) *Годишен извештај од обработени податоци за квалитетот на животната средина за 2012 година*.
- [10] Министерство за животна средина и просторно планирање (2013) *Правилник за стандардите за биоразградливост кои треба да ги исполнуваат кесите за транспорт на стоки, начинот на пуштање и употреба на биоразградливи кеси за транспорт на стоки на пазар*.
- [11] Министерство за животна средина и просторно планирање (2014) *Годишен извештај од обработени податоци за квалитетот на животната средина за 2013 година*.
- [12] Министерство за животна средина и просторно планирање (2015) *Годишен извештај од обработени податоци за квалитетот на животната средина за 2014 година*.
- [13] Министерство за животна средина и просторно планирање и шведска Агенција за заштита на животната средина (2011) *Градење на квалитетот за имплементација на ЕУ Директива за дејонии -затворање на нестандартните дејонии и инсекции*.
- [14] Службен весник на РМ бр. 68/2004. *Закон за управување со отпад*.
- [15] Службен весник на РМ бр. 53/2005. *Закон за животна средина*.
- [16] Службен весник на РМ бр. 161/2009. *Закон за управување со пакување и отпад од пакување*.
- [17] Службен весник на РМ бр. 140/2010. *Закон за управување со бањерии и акумулатори и отпадни бањерии и акумулатори*.
- [18] Службен весник на РМ бр. 52/2010. *Листа на илустративни примери за пакување*.
- [19] Службен весник на РМ бр. 52/2011. *Правилник за начинот на означување на бањериите и акумулаториите и на бањериските пакувања, формата и содржината на симболот за одделно собирање како и содржината и формата на хемискиот симбол за мейали (*)*.

- [20] Службен весник на РМ бр. 6/2012. *Закон за ујравување со елекџрична и елекџронска ојрема и ојџагна елекџрична и елекџронска ојрема.*
- [21] Службен весник на РМ бр. 9/2013. *Правилник за минимални барања за одвоен џрејман на ојџагнајта ојрема, мајеријалијте и деловијте на ојџагнајта ојрема, како и минималнијте џтехнички услови за складирање и џрејман на ојџагнајта ојрема која џтреба да џи исполнува инсталацијајта за џрејман на ојџагна ојрема.*
- [22] Службен весник на РМ бр, 177/2014. *Одлука за џрекин на џосџайкајта за доделување на концесија за финансирање, џроекџирање, изџрабда и ујравување со реџионална дејонија за комунален џврсџ ојџаг во Јуџосџојчиојџ џлански реџион.*
- [23] Службен весник на РМ бр, 142/2014. *Одлука за џрекин на џосџайкајта за доделување на концесија за финансирање, џроекџирање, изџрабда и ујравување со реџионална дејонија за комунален џврсџ ојџаг во Полошкиојџ џлански реџион.*
- [24] Sapuric, Z., Dimitrovski, D., Dimitrovski, M. and Kochubovski, M. (2015) European Union Regulations and Standards of Waste Management and Its Implementation in FYR Macedonia. *Journal of environmental protection and ecology Vol.16.*
- [25] United States Environmental Protection Agency (2013) *Technical update of the social cost of carbon for regulatory impact analysis – under executive order 12866.* United States Government.
- [26] World Bank (2012) *What a waste: A global review of solid waste management.* Urban development series knowledge papers No. 15.